

GJYKATA E QARKUT PRIZREN

P 09/10

6 korrik 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut Prizren në trupin gjykues prej tre gjyqtarësh, të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Dean B. Pineles si kryetar i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Witold Jakimko dhe gjyqtarja vendore për të mitur Ajsere Skënderi, si anëtarë të trupit gjykues, në lëndën penale kundër:

A

I pandehuri dyshohet se ka kryer këto vepra penale në bashkëkryerje me te pandehurin tjeter

B

1. Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës kombëtare, raciale, fetare ose etnike, në shkelje të Nenit 115 paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.
2. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm me pasojë humbjen e konsiderueshme të pasurisë, në shkelje të Nenit 291 paragrafi 1 të KPPK-së lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.
3. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm me pasojë humbjen e konsiderueshme të pasurisë, në shkelje të Nenit 291 paragrafi 1 të KPPK-së lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.

Mbas mbajtjes se seances kryesore me 6 Korrik, 2011 Gjykata shqipton këto



AKTGJYKIM

Në bazë të Nenit 389, paragrafi 4 të KPPK-së, gjykata i refuzon akuzat kundër A
mbi bazën se ndjekja e mëtejshme penale përjashtohet nga dispozitat e
Nenit 9, paragrafët 1 dhe 2, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM).

Për shkak se ndjekja përjashtohet, i dëmtuari nuk ka të drejta të mëtutjeshme për
të ushtruar ndjekjen penale.

A
Po kështu, B irohet nga çdo detyrim për të paguar shpenzimet e
procedurës penale në bazë të Nenit 391 (1) 6).


ARSYETIM

Më 21 mars 2006, prokurori publik ndërkombe tar ushtroi aktakuzë për akuzat e
mësipërme. Këto akuza lindën për shkak të trazirave civile të datave 17-18 mars
2004. Në kohën e krimeve të pretenduar, A ishte 15 vjec, B
C ishte 18 vjec në atë kohë.

B
A
Aktakuza kundër C u konfirmua më 28 prill 2006, dhe kundër D më
6 nëntor 2006. Trupi gjykues për të mitur i Gjykatës së Qarkut Prizren e bashkoi
procedurën penale kundër të miturit E me atë kundër F.

Shqyrtimi kryesor në Gjykatën e Qarkut Prizren filloi më 27 nëntor 2006 B dhe
përfundoi më 15 qershor 2007, me shqiptimin e Aktgjykitit sipas të cilit, G
dhe H u shpallën fajtorë për veprat penale I u dënuar me dënim unik
prej katër vitesh; J u dënuar me dërgim në institucionin e edukimit
korrektues në Lipjan për një periudhë dy vjeçare.

Mbrojtësit e tyre ushtruan ankesë kundër Aktgjykitit. Më 8 dhjetor 2009, Gjykata
Supreme e Kosovës e anuloi Aktgjykitin dhe e ktheu lëndën përrishqyrtim dhe
vendosje në Gjykatën e Qarkut Prizren. Në kohën e këtij vendimi, K ishte
21 vjec.



Në dhjetor 2010, në Gjykatën e Qarkut Prizren u zhvillua një seancë paraprake. Megjithatë, për shkak të ndryshimit të gjyqtarëve të EULEX-it, më 18 maj 2011 u zhvillua një seancë tjetër paraprake. Në këtë seancë ishin prezent prokurori i EULEX-it, mbrojtësit e dy të pandehurve dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar.

Në këtë seancë paraprake, gjykata diskutoi për parashikimin e Nenit 9, paragrafi 1, të KDPM-së, i cili, nëse është i zbatueshëm, përjashton ndjekjen penale kundër

A. *...*

Neni 9, paragrafi 1 parashikon kështu:

1. *Procedura gjyqësore nuk mund të zbatohet ndaj madhorit të ri i cili ka mbushur moshën njëzet e një (21) vjeç për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç.*


Versioni i tanishëm i KDPM-së, përfshirë Nenin 9, hyri në fuqi në mes të vitit 2010. Neni 9 është i njëjtë me Nenin 8 të versionit të mëparshëm të KDPM-së që hyri në fuqi më 20 prill 2004, menjëherë pas ngjarjeve në fjalë më 17-18 mars 2004.

Megjithatë gjykata është e mendimit se Neni 9 është i zbatueshëm, si ligjërisht ashtu dhe faktikisht, për arsyet e mëposhtme.

Së pari, Neni 156 i KDPM-së parashikon që, nëse procedura përgatitore ka filluar para 6 prillit 2004, atëherë ajo duhet të vazhdohet dhe përfundohet sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm të zbatueshëm—dispozitat për të miturit në Kodin Penal të RSFJ-së, veçanërisht Neni 81.¹ Meqenëse procedura përgatitore ka filluar më 28 tetor 2004, Kodi Penal i RSFJ-së nuk zbatohet.

Po kështu, Neni 161 i KDPM-së në fuqi përcakton se Kodi shfuqizon çdo version të mëparshëm të miratuar në vitin 2004, si dhe “çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.” Kështu që, përderisa Neni 81 i ligjit të mëparshëm është në kundërshtim me Nenin 9 të tanishëm, atëherë përparësi ka Neni 9.

¹ Neni 81 (1) shpall se “I rrituri i cili ka mbushur moshën 21 vjeç ose më shumë, nuk mund të zbatohet për vepër penale që ai e ka kryer si i mitur,” që është një person ndërmjet moshës 14 dhe 16 vjeçshës (Neni 73 (1)).



Për më tepër, përderisa Neni 9 mund të jetë më i favorshëm për kryerësin se Neni 81 i ligjit të mëparshëm të zbatueshëm, atëherë Nenit 9 duhet t'i jepet përparësi për shkak të parimit të përcaktuar në Nenin 2 të Kodit Penal të Kosovës (të përfshirë së referencë në Nenin 5 të KDPM-së), i cili parashikon se, në rast të ndryshimit të ligjit, "zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin."

Pasi ka përcaktuar se zbatohet Neni 9 i KDM-së, gjykata do të trajtojë gjendjen faktike të tanishme. Tani ~~A~~ është madhor, sipas përkufizimit në Nenin 2, parografi 1, nën-parografi 1.7 të KDM-së—person i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç—dhe ishte i mitur nën moshën 16 vjeç në kohën e kryerjes së veprave të pretenduara. Kështu, në rast se për këtë ndalim të përgjithshëm nuk zbatohet ndonjë përjashtim, atëherë kundër tij nuk mund të "zbatohet" ose të zhvillohet procedurë gjyqësore e mëtutjeshme.

Parografi 2 i Nenit 9 të KDPM-së nuk përmban asnjë përjashtim, por përmendimin e gjykatës është i pazbatueshëm për situatën e tanishme. Në pjesën përkatëse, Neni përcakton kështu:

2. *Procedura gjyqësore mund të zbatohet ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç vetëm nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se pesë (5) vite burgim.*

Në Nenin 2, parografi 1, nën-parografi 1.5, "madhor i ri" quhet personi midis moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe njëzet e një (21) vjeç. Duke qenë 23 vjeç ~~A~~ nuk është më madhor i ri, prandaj ky përjashtim nuk zbatohet. (Në të vërtetë, ~~A~~ nuk ishte madhor i ri as në kohën e vendimit të Gjykatës Supreme më 8 dhjetor 2009.)

Po kështu, Neni 10 i KDPM-së parashikon që procedura penale mund të zbatohet dhe dënim i të caktuhet ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën 23 vjeç, por vetëm në rrethanat kur vepra penale është kryer nga "i mituri i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç." Në rastin tonë, ndonëse ~~A~~ tani



është 23 vjeç, ai nuk kishte mbushur ende moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç në kohën kur u kryen veprat e pretenduara. Prandaj kjo dispozitë nuk zbatohet.

Në kushtet e kësaj gjendjeje faktike, gjykata tani do të procedojë sipas Nenit 34 të KPPK-së, i cili parashikon se:

(1) *Gjykata e cila ... është kompetente për shkaqe të rëndësishme ose për arsyet e efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të urdhërojë vëçimin e procedurave të zbatuara ... kundër disa të pandehurve dhe procedon ndaras ...*

Për mendimin e gjykatës, arsyet e diskutuara më lart janë sigurisht të rëndësishme dhe justifikojnë vëçimin e lëndës së A nga ajo e bashkë-kryerësit.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 389, paragrafi 4, gjykata është e detyruar të shqiptojë Aktgjykim që i refuzon akuzat nëse "...ka...rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale", si në këtë rast.

Ky Aktgjykim që përjashton procedurën gjyqësore të mëtutjeshme, prek palën e dëmtuar në të njëjtën mënyrë si dhe prokurorin. Kjo do të thotë se pala e dëmtuar përjashtohet nga ndjekja e procedurës penale në mënyrë të pavarur, ndryshe nga situatat e parashikuara në Nenin 62 të KPPK-së. Megjithatë ky Aktgjykim nuk ka pasoja mbi lëndën e B, e cila do të shkojë në shqyrtim kryesor. Për shkak të vëçimit, lëndës së B do t'i caktohet një numër i ri reference.

Për rrjedhojë, gjykata vendos si në dispozitiv.



Dean B. Pineles
Kryetar i trupit gjykues


Witold Jakimko
Anëtar i trupit gjykues

Ajsere Skënderi
Anëtare e trupit gjykues

Vlora Johnston
Procesmbajtes

MJET LIGJOR

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita kur atyre u kopja e tij. Anesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut Prizren.



A handwritten signature is placed over the circular stamp, appearing to be a stylized "W".